



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO			
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS			
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA			
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO			
Pranimi / Bërëzia / Prapimë / Pri. data / Received / Dated	22.02	2021	1 viti / god. year
Organ / Instit. Organ / Odgov. / Org. / Inst.	No. Pril. to Pril. Pril. No.	Shtojca / Prilog. Appendix	Sasia / Kolicina Quantity
SKPMOHCK	759/2021		113



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.08/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Jeton Koca-Demi-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Ilire Mehmeti Shaqiri Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.08/2021 të datës 08.01.2021, të parashtruar nga grup ankuesish dhe të cilët me autorizim i përfaqëson avokati me adresë banimin Rr."Afrim Zhitia", pn, Komuna e Mitrovicës, kundër organit të punësimit Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 22.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet **jo kompetent** për të vendosur për ankesën me numër A.nr.08/2021 të datës 08.01.2021 të parashtruar nga ankuesit dhe

A r s y e t i m

Ankuesit dhe të punësuar në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" më datë 08.01.2021 përmes përfaqësuesit të autorizuar avokatit kanë parashtruar ankesë me numër protokoll 48/2021 të regjistruar me numër A.nr.08/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për njohjen e të drejtës për kompensimin e të ardhurave personale sipas Vendimit Nr.02/151 të datës 06.01.2011, të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 48/2021 të regjistruar me numër A.nr.08/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 27.11.2019; Akt Emërimit me Nr.ref 1/33 të datës 24.04.2012; Emalin e datës 19.02.2021 të F.H për I.M.SH;



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga ankuesit dhe sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka konstatuar se ankuesi është profesor ndërsa i Bibliotekës pran Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë, në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina".

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave lidhur me pranueshmerinë e ankesës ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht neni 2 ku përcaktohet se 3. *Nëpunës civil - është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë: 4. Nëpunës i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike, dhe si rrjedhojë ka konstatuar se zyrtaret publik të nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe shërbimeve të brendshme në kuadër të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë në Kosovë, respektivisht në Universitet Publike, kanë statusin e nëpunësit të Shërbimit Publik.*

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civilë si dhe duke marr parasysh konstatimin se ankuesit kanë statusin e nëpunësit të Shërbimit Publik, Kolegji konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.08/2021 të datës 08.01.2021 të parashtruar nga ankuesit dhe

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, bazuar në dispozitat e nenit 24 dhe 74 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konstaton se zyrtaret publik me status të nëpunësit të Shërbimit Publik kanë të drejtë të ankohen te punëdhënësi dhe më pas mund të fillojnë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.08/2021

Ilire Mehmeti - Shaqiri

Procesmbajtëse

Jeton Koca

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesve, avokatit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina".
- Udhëheqësit të Personelit në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina".
- Arkivit të KPMSHCK-së.

